



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më.14 nëntor 2011
Nr. ref.: RK160/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 118-10

Parashtruesi

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14.1.7 të
Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me adresë në Rr. Enver Maloku 95, Prishtinë, përmes Fatos Zajmit, Fatbardh Makollit dhe Rustem Qehajes, respektivisht përfaqësues të kompanive të sigurimit Illyria, Siguria dhe Sigkos.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon anulimin e nenit 14.1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Parashtruesi, gjithashtu ka kërkuar masa të përkohshme për të ndaluar implementimin e nenit 14.1.7 të Ligjit prej datës së dorëzimit të kërkesës deri sa një vendim meritor të lëshohet nga Gjykata.

Objekti i çështjes

3. Çështja ka të bëjë me nenin 14.1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili parasheh që Kryqi i Kuq i Kosovës do të financohet, pjesërisht, duke ua imponuar 1% të primit bruto të sigurimit të detyrueshëm motorik në Kosovë.

4. Neni 14.1.7 i Ligjit të kontestuar parasheh si në vijim:

“1. me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe objektivave të përcaktuara me këtë Ligj, Kryqi i Kuq i Kosovës do të fitojë mjetet nga burimet në vijim:...
1.7 siguri i detyrueshëm i automjeteve 1% (një për qind) të primit bruto të vlerës së sigurimit të mjeteve;...”

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 54 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 26 nëntor 2010, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese.
7. Kryetari i Gjykatës emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan, kryesues, dhe Altay Suroy e Almiro Rodriguez.
8. Më 13 dhjetor 2010, Gjykata u këshillua dhe shqyrtoi në seancë të mbyllur raportin paraprak të Gjyqtarit raportues në lidhje me kërkesën për masa të përkohshme, dhe refuzoi që t'i jepet masa e përkohshme, ndërsa vendimi për atë qëllim iu lëshua palëve më 17 dhjetor 2010.
9. Më 27 janar 2011, kërkesa për përgjigje u dorëzua në Kuvendin e Kosovës. Asnjë përgjigje nuk u pranua nga Kuvendi.
10. Nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës u pranua një letër ku Gjykata Kushtetuese njoftohej për ndryshimin e adresës së Shoqatës.
11. Më 23 maj 2011, Gjykata u këshillua në seancë të mbyllur për pranueshmërinë e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi konsideron se imponimi i një pagese për kompanitë e sigurimeve nga 1 % e vlerës së gjithë primeve të sigurimit të detyrueshëm të përfshirë në Ligj, do të rezultojë me një privim të padrejtë dhe jokushtetues. Shuma që konsiderohet si e

rrezikuar, sipas parashtruesit, dhe në bazë të vlerave të fundit të primeve të sigurimit në Republikën e Kosovës, arrin një vlerë prej 490.232,21€ , për çdo vit kalendarik.

13. Parashtruesi konsideron se neni i kontestuar i Ligjit kundërshton nenet e mëposhtme të Kushtetutës:

Neni 3	Barazia para ligjit;
Neni 10	Ekonomia;
Neni 24	Barazia para Ligjit;
Neni 49	E drejta për punë dhe ushtrimin e profesionit; dhe
Neni 119.2	Marrëdhëniet ekonomike – Parimet e përgjithshme

Pranueshmëria e kërkesës

14. Në mënyrë që të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

15. Në lidhje me këtë, neni 113.7 i Kushtetutës konstaton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkëljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

16. Për më tepër, neni 48 i Ligjit konstaton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

17. Në këtë kërkesë, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës dëshiron të kontestojë një nen të veçantë të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës. Në mënyrë që të mund ta bëjë këtë, parashtruesi duhet të jetë person fizik ose ligjor (shih rastin e Universitetit AAB-RIINVEST L.L.C Prishtinë, kundër Qeverisë së Kosovës, rasti nr. KI 49/ 09) të drejtat kushtetuese të të cilit janë personalisht ose direkt të ndikuara nga një masë ose akt i autoritetit publik. Kushtetuta nuk parasheh ngritjen e një *actio popularis*. Me fjalë të tjera, parashtruesi nuk mund të ankohet në abstrakt lidhur me masat nga autoritetet publike të cilat nuk janë aplikuar për atë personalisht, sikurse është rasti para kësaj Gjykate.

18. Në rastin konkret, parashtruesi është një shoqatë që përfaqëson interesat e ngushta (të veçanta), dmth. kompanitë e sigurimeve që udhëheqin biznes në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur prova që do të tregonin shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, vendimi i KEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

19. Neni i kontestuar i Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, nuk ndikon në parashtruesin dhe në asnjë organ tjetër ose shoqatë, sa i përket tarifave ose taksave mbi kompanitë e sigurimeve. Nga kjo del se, parashtruesi nuk është një palë e autorizuar dhe kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani